

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PRONAVE

Nr. 810 Prot.

Fier, më 23.01.2026

Projekt - Vendim

Nr. 05 datë 23.01.2026

“Për miratimin në parim të kërkesës së shoqërisë “Elkos Group” sh.p.k, për vijimin e procedurave administrative për vlerësimin dhe shkëmbimin e pasurive objekt i kontratës noteriale nr. 963 rep. nr. 471 kol. datë 20.03.2013 ndërmjet palës porositëse Bashkia Fier dhe palës sipërmarrëse shoqëria “Elkos Group” sh.p.k”.

Në bazë të nenit 8, pika 2, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 574 dt. 28.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, Qarku Fier” i ndryshuar, Vendimit nr. 39, date 30.10.2012 të Këshillit Bashkiak Fier, Kontratës nr. 963 rep. nr. 471 kol. datë 20.03.2013, kërkesës nr. 112 prot. datë 07.01.2021 dhe nr. 2643 prot. dt. 24.03.2023 të shoqërisë “Elkos Group” sh.p.k., **Kryetari i Bashkisë;**

PROPOZON

1. Miratimin në parim të kërkesës së shoqërisë “Elkos Group” sh.p.k, për vijimin e procedurave administrative për vlerësimin dhe shkëmbimin e pasurive objekt i kontratës noteriale nr. 963 rep. nr. 471 kol. datë 20.03.2013 ndërmjet palës porositëse Bashkia Fier dhe palës sipërmarrëse shoqëria “Elkos Group” sh.p.k.
2. Autorizohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e procedurave të mëtejshme administrativo – ligjore për vlerësimin dhe shkëmbimin e pasurive.

Drejtorja e Menaxhimit të Pronave
SNL: M.Petushi

Drejtorja Juridike
Drejto: E. Kapllanaj

Drejtorja e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Drejto: P. Çina

Drejtorja e Urbanistikës dhe Sinjalistikës Rrugore
Drejto: F. Troka

KRYETARI
Armando SUBASHI

